



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. 175/8 Prot.

Vlorë më, 20 . 01 .2026

VENDIM

Nr. 8, datë 20.01.2026

PËR

MIRATIMIN E KRITEREVE TË PRANIMIT TË STUDENTËVE NË PROGRAMET E
STUDIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2026-2027 NË UNIVERSITETIN "ISMAIL
QEMALI", VLORË DHE PUBLIKIMIN E TYRE

Në mbështetje të nenit 38,74, 76, 78, të Ligjit nr. 80/ 2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", nenit 19, pika 1, gërma f, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; shkresës së Ministrisë së Arsimit nr.8230 Prot., datë 19.12.2025 si dhe referuar propozimit të Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmës Akademike të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, ardhur me shkresën nr 168 prot., datë 20.01.2026, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 20.01.2026,

VENDOSI:

1. Të miratojë kriteret e pranimit në programet e studimit në të gjitha ciklet për vitin akademik 2026-2027, sipas materialit bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.
2. Kriteret e pranimit të studentëve në programet e studimit, që do të ofrohen në vitin akademik 2026-2027, të publikohen brenda muajit Janar 2026 në faqen zyrtare të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë dhe në portalin U-Albania
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Zëvendësrektori Akademik, Drejtuesit e Njësive Kryesore dhe Drejtoria e Shërbimeve Ndihmës Akademike.
4. Kriteret e miratuara i përcillen Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe Ministrisë së Arsimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

NËNKRYETARI I SENATIT AKADEMIK

PROF. ASOC. DENADA SOTA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

I. FAKULTETI I EKONOMISË

• **Bachelor në "Administrim Biznesi"**

1. Kriteret e parashikuara nga ligji Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 74 pika 1 "*Pranimi në programet e studimit të ciklit të parë është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave*".
2. Nota mesatare e përgjithshme në tre vitet e studimit duke përfshirë dhe provimet e Maturës Shtetërore.

• **Bachelor në "Marketing"**

1. Kriteret e parashikuara nga ligji Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 74 pika 1 "*Pranimi në programet e studimit të ciklit të parë është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave*".
2. Nota mesatare e përgjithshme në tre vitet e studimit duke përfshirë dhe provimet e Maturës Shtetërore.

• **Bachelor në "Menaxhim Turizmi"**

1. Kriteret e parashikuara nga ligji Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 74 pika 1 "*Pranimi në programet e studimit të ciklit të parë është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave*".
2. Nota mesatare e përgjithshme në tre vitet e studimit duke përfshirë dhe provimet e Maturës Shtetërore.

• **Bachelor në "Financë":**

1. Kriteret e parashikuara nga ligji Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 74 pika 1 "*Pranimi në programet e studimit të ciklit të parë është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave*".
2. Nota mesatare e përgjithshme në tre vitet e studimit duke përfshirë dhe provimet e Maturës Shtetërore të ketë 100 përqind të vlerësimit në renditje.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

- **Bachelor në "Kontabilitet"**

1. Kriteret e parashikuara nga ligji Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 74 pika 1 "*Pranimi në programet e studimit të ciklit të parë është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave*".
2. Nota mesatare e përgjithshme në tre vitet e studimit duke përfshirë dhe provimet e Maturës Shtetërore të ketë 100 përqind të vlerësimit në renditje

- **Bachelor në "Ekonomiks"**

1. Kriteri i notës msatare të përgjithshme të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave (Ligjit Nr.80/2015, neni 74 pika 1 dhe e parashikuar në nenin 63, të Rregullores së UV "Pranimi në Ciklin e Parë të Studimeve)

- **Master Profesional në " Kontabilitet "**

1. Do të pranohen kandidatë të cilët zotërojnë të paktën një diplomë "Bachelor" në fushën e ekonomisë apo fusha të tjera studimi.
2. Ose janë diplomuar jashtë vendit në një program të ciklit të parë "Bachelor" në fushën e ekonomisë apo fusha të tjera studimi dhe kanë kryer njehsimin e diplomës pranë ministrisë përkatëse.

- **Master Profesional në " Financë "**

1. Do të pranohen kandidatë të cilët zotërojnë të paktën një diplomë "Bachelor" në fushën e ekonomisë apo fusha të tjera studimi.
2. Ose janë diplomuar jashtë vendit në një program të ciklit të parë "Bachelor" në fushën e ekonomisë apo fusha të tjera studimi dhe kanë kryer njehsimin e diplomës pranë ministrisë përkatëse.

- **Master Profesional në "Marketing"**

1. Në programet e studimit Master Profesional në "Marketing" në Fakultetin e Ekonomisë do të pranohen kandidatë të cilët zotërojnë të paktën një diplomë "Bachelor" në fushën e ekonomisë apo fusha të tjera studimi. Përparësi do të kenë kandidatët të cilët zotërojnë diplomë në fushën e studimit të programit përkatës, më pas do të renditen kandidatët të cilët zotërojnë një diplomë Bachelor në fushën e ekonomisë, dhe në fund kandidatët që zotërojnë një diplomë në fusha të tjera studimi. Kandidatët do të përzgjidhen mbi bazën e notës mesatare dhe diplomës që zotëron.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

Master Profesional "Sipërmarrje në turizëm"

1. Në programet e studimit Master i Profesional në "Sipërmarrje në Turizëm" në Fakultetin e Ekonomisë do të pranohen kandidatët të cilët zotërojnë të paktën një diplomë "Bachelor" në fushën e ekonomisë apo fusha të tjera studimi. Përparësi do të kenë kandidatët të cilët zotërojnë diplomë në fushën e studimit të programit përkatës, më pas do të renditen kandidatët të cilët zotërojnë një diplomë Bachelor në fushën e ekonomisë, dhe në fund kandidatët që zotërojnë një diplomë në fusha të tjera studimi. Kandidatët do të përzgjidhen mbi bazën e notës mesatare dhe diplomës që zotërojnë.

Master Profesional në "Ekonomiks në Sipërmarrje"

1. Do të pranohen kandidatët të cilët zotërojnë të paktën një diplomë të nivelit "Bachelor" në ekonomi, apo dhe fusha të tjera studimi të ngjashme, të renditur sipas mesatares;
2. Ose janë diplomuar jashtë vendit në një program të ciklit të parë "Bachelor" në fushën e ekonomisë dhe kanë kryer njehsimin e diplomës pranë ministrisë përkatëse.

• **Master i Shkencave në "Administrim Biznesi"**

Kanë të drejtë të aplikojnë kandidatët që:

1. Zotërojnë të paktën një diplomë "Bachelor" në Ekonomi, apo dhe fusha të tjera studimi. Kandidatët do të përzgjidhen mbi bazën e notës mesatare dhe diplomës që zotërojnë.

• **Master i Shkencave në "Ekonomiks"**

Kanë të drejtë të aplikojnë kandidatët që:

1. Kandidatët të cilët plotësojnë kriteret Ligjit nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 76, "Pranimi në ciklin e dytë të studimeve"
2. Zotërojnë të paktën një diplomë të nivelit "**Bachelor**" në një nga degët ekonomi, apo dhe në fusha të tjera studimi të përafërta;
3. Ose janë diplomuar jashtë vendit në një program të ciklit të parë "Bachelor" në fushën e ekonomisë dhe kanë kryer njehsimin e diplomës pranë ministrisë përkatëse.
4. Përparësi do të kenë kandidatët të cilët zotërojnë diplomë Bachelor në fushën e Ekonomisë që kanë përfunduar studimet pranë Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, renditur sipas mesatares. Më tej kandidatët do të përzgjidhen mbi bazën e notës mesatare dhe diplomës që zotëron.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

• **Master i Shkencave në "Pasuritë e Paluajtshme"**

1. Kandidatët të cilët plotësojnë kriteret e ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 76, pika 3, "Pranimi në ciklin e dytë të studimeve"
2. Kandidatë të cilët zotërojnë të paktën një diplomë "Bachelor" në fushën e ekonomisë apo fusha të tjera studimi.
3. Ose janë diplomuar jashtë vendit në një program të ciklit të parë "Bachelor" në fushën e ekonomisë apo fusha të tjera studimi dhe kanë kryer njehsimin e diplomës pranë ministrisë përkatës.
4. Përparësi do të kenë kandidatët të cilët zotërojnë diplomë në fushën e studimit Financë, Kontabilitet, në fushën e ekonomisë që kanë përfunduar studimet pranë Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, renditur sipas mesatares. Më tej kandidatët do të përzgjidhen mbi bazën e notës mesatare që zotëron.

• **Master i Shkencave në "Finance"**

1. Kandidatët të cilët plotësojnë kriteret e ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 76, pika 3, "Pranimi në ciklin e dytë të studimeve"
2. Kandidatë të cilët zotërojnë të paktën një diplomë "Bachelor" në fushën e ekonomisë apo fusha të tjera studimi.
3. Ose janë diplomuar jashtë vendit në një program të ciklit të parë "Bachelor" në fushën e ekonomisë apo fusha të tjera studimi dhe kanë kryer njehsimin e diplomës pranë ministrisë përkatëse
4. Përparësi do të kenë kandidatët të cilët zotërojnë diplomë në fushën e studimit Financë, Kontabilitet, në fushën e ekonomisë që kanë përfunduar studimet pranë Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, renditur sipas mesatares. Më tej kandidatët do të përzgjidhen mbi bazën e notës mesatare që zotëron.

• **Master i Shkencave në "Projektim dhe Menaxhim i Sistemeve Turistike dhe Kulturore"**

Kanë të drejtë të aplikojnë kandidatët që:

1. Zotërojnë të paktën një diplomë "Bachelor" në Ekonomi, apo dhe fusha të tjera studimi. Kandidatët do të përzgjidhen mbi bazën e notës mesatare dhe diplomës që zotërojnë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

- **Master i Shkencave në "Marketing Digjital"**

Kanë të drejtë të aplikojnë kandidatët që:

1. Zotërojnë të paktën një diplomë "Bachelor" në Ekonomi, apo dhe fusha të tjera studimi. Kandidatët do të përzgjidhen mbi bazën e notes mesatare dhe diplomës që zotërojnë.

- **Master i Shkencave në "Administrim Publik"**

Kanë të drejtë të aplikojnë kandidatët që:

Zotërojnë të paktën një diplomë të nivelit "Bachelor" në ekonomi, apo dhe fusha të tjera studimi. Kandidatët do të përzgjidhen mbi bazën e notës mesatare dhe diplomës që zotërojnë.

II.FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE

- **Program profesional "Udhërrëfyes turistik për rajonin e jugut"**

1. Mund të aplikojnë të gjithë kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm, të përgjithshëm dhe/ose profesional.

- **Bachelor në "Gjuhë angleze"**

1. Nota mesatare e tri viteve të studimit dhe e provimeve të maturës shtetërore të ketë 100% të vlerësimit në renditje.

- **Bachelor në "Gjuhë italiane"**

1. Nota mesatare e tri viteve të studimit dhe e provimeve të maturës shtetërore të ketë 100% të vlerësimit në renditje.

- **Master Shkencor "Mësuesi në gjuhë të huaj ,gjuhë angleze"**

1. Kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë në një program të ciklit të parë "Bachelor" në gjuhë të huaj.
2. Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë "Bachelor" ose në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë në gjuhë të huaj dhe kanë kryer njësimin e diplomës pranë MAS-it.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

3. Përcaktimi i kandidatëve fitues do të kryhet sipas rendit zbritës të notës së tyre mesatare deri në plotësimin e kuotave të shpallura.
4. Parapëlqehen kandidatët që e kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve pranë UV-së.

• **Bachelor në "Gjuhë shqipe dhe Letërsi"**

1. Nota mesatare e tri viteve të studimit dhe e provimeve të maturës shtetërore të ketë 100% të vlerësimit në renditje.

• **Bachelor në "Gjuhësi e aplikuar në fushën e turizmit"**

1. Nota mesatare e tri viteve të studimit dhe e provimeve të maturës shtetërore të ketë 100% të vlerësimit në renditje.

• **Bachelor në "Media, Komunikim dhe Trashëgimi kulturore"**

1. Nota mesatare e tri viteve të studimit dhe e provimeve të maturës shtetërore të ketë 100% të vlerësimit në renditje.

• **Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor"**

1. Nota mesatare e tri viteve të studimit dhe e provimeve të maturës shtetërore të ketë 100% të vlerësimit në renditje.

• **Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor"**

1. Nota mesatare e tri viteve të studimit dhe e provimeve të maturës shtetërore të ketë 100% të vlerësimit në renditje.

• **Bachelor në "Pedagogji e Specializuar"**

1. Nota mesatare e tri viteve të studimit dhe e provimeve të maturës shtetërore të ketë 100% të vlerësimit në renditje.

• **Bachelor në "Histori – Gjeografi"**

1. Nota mesatare e tri viteve të studimit dhe e provimeve të maturës shtetërore të ketë 100% të vlerësimit në renditje.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

• **Master profesional në "Mësuesi për Ciklin e Lartë të Arsimit Bazë në lëndën gjuhë italiane"**

Kanë të drejtë të aplikojnë në programet e ciklit të dytë të studimeve "Master profesional" në Departamentin e Gjuhëve të Huaja, kandidatët që:

1. Kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë në një program të ciklit të parë "Bachelor" në gjuhë të huaj.
2. Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë "Bachelor" ose në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë në gjuhë të huaj dhe kanë kryer njësimin e diplomës pranë MAS-it.
3. Përcaktimi i kandidatëve fitues do të kryhet sipas rendit zbritës të notës së tyre mesatare deri në plotësimin e kuotave të shpallura.
4. Parapëlqehen kandidatët që e kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve pranë UV-së.
5. Kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë në një program të ciklit të parë "Bachelor" në gjuhë të huaj.
6. Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë "Bachelor" ose në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë në gjuhë të huaj dhe kanë kryer njësimin e diplomës pranë MAS-it.
7. Përcaktimi i kandidatëve fitues do të kryhet sipas rendit zbritës të notës së tyre mesatare deri në plotësimin e kuotave të shpallura.
8. Parapëlqehen kandidatët që e kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve pranë UV-së.

• **Master profesional në Udhërrëfim dhe komunikim turistik"**

1. Kanë mbaruar ciklin e parë të studimeve;
2. Preferohen kandidatë që kanë kryer ciklin e parë të studimeve "Bachelor" në fushat: gjuhë e huaj, histori, gjeografi, trashëgimi kulturore, turizëm/manaxhim turizmi, marketing, ekonomiks, gjuhë shqipe dhe letërsi, navigacion e disiplina të ngjashme me to.
3. Renditja e kandidatëve fitues do të kryhet sipas rendit zbritës bazuar në mesataren e përgjithshme të tre viteve të studimit të ciklit të parë "Bachelor".
4. Në rast të kandidatëve me pikë të barabarta, prioritet do t'i jepet kandidatëve që vijnë nga fusha pararendëse të programit (shih më poshtë). Në rast se ka ende kandidatë me pikë të barabarta, prioritet do të kenë kandidatët që ciklin e parë të studimeve e kanë kryer në UV.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

• **Master profesional në "E drejtë penale"**

1. Kanë të drejtë të aplikojnë kandidatët që kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë në një program të ciklit të parë Bachelor në «Drejtësi» ose fusha të përafërta.
2. Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë "Bachelor" ose në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë në «Drejtësi» ose fusha të përafërta dhe kanë kryer njësimin e diplomës pranë MAS.
3. Përcaktimi i kandidatëve fitues do të kryhet sipas rendit zbritës së notës së tyre mesatare, deri në plotësimin e kuotave të shpallura.
4. Do të kenë përparësi kandidatët që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në drejtësi pranë UIQV-së, si dhe kandidatët e diplomuar pranë Akademisë së Sigurisë dhe Hetimit pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Shqipërisë

• **Master Profesional në "Shkenca administrative"**

1. Kanë të drejtë të aplikojnë kandidatët që kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë në një program të ciklit të parë Bachelor në «Drejtësi» ose fusha të përafërta.
2. Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë "Bachelor" ose në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë në «Drejtësi» ose fusha të përafërta dhe kanë kryer njësimin e diplomës pranë MAS.
3. Përcaktimi i kandidatëve fitues do të kryhet sipas rendit zbritës së notës së tyre mesatare, deri në plotësimin e kuotave të shpallura.
4. Do të kenë përparësi kandidatët që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në drejtësi pranë UIQV-së, si dhe kandidatët e diplomuar pranë Akademisë së Sigurisë dhe Hetimit pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Shqipërisë

Master Profesional në "Mësuesi për Arsimin fillor Kl I-V"

Kanë të drejtë të aplikojnë kandidatët që:

1. Kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë në një program të ciklit të parë "Bachelor" në *"Mësuesi për Arsimin Fillor", "Mësuesi për Arsimin Parashkollor", "Pedagogji e specializuar"* dhe dege të tjera me drejtim mësuesi.
2. Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë "Bachelor" në mësuesi dhe kanë kryer njësimin e diplomës pranë MAS-it.
3. Përcaktimi i kandidatëve fitues do të kryhet sipas rendit zbritës të notës së tyre mesatare deri në plotësimin e kuotave të shpallura.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

• **Master Profesional në "Mësuesi ne Histori – Gjeografi"**

Kanë të drejtë të aplikojnë kandidatët që:

1. Kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë në një program të ciklit të parë të fushave ngjashme.
2. Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë të fushave të ngjashme dhe kanë kryer njësimin e diplomës pranë MAS-it.
3. Përcaktimi i kandidatëve fitues do të kryhet sipas rendit zbritës të notës së tyre mesatare deri në plotësimin e kuotave të shpallura.

• **Program i Integruar Ciklit të Dytë "Master i Shkencave" në "Drejtësi".**

1. Pranimi i studentëve të rinj në vitin akademik 2026-2027 të kryhet 100% në bazë të mesatares së të gjithë viteve të studimeve në ciklin e mesëm dhe mesatares së provimit të maturës.

• **Master i shkencave në "Përkthim dhe interpretim"**

1. Kanë të drejtë të aplikojnë kandidatët që kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë në një program të ciklit të parë "Bachelor" në gjuhë të huaj.
2. Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë "Bachelor" ose në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë në gjuhë të huaj dhe kanë kryer njësimin e diplomës pranë MAS-it.
3. Përcaktimi i kandidatëve fitues do të kryhet sipas rendit zbritës të notës së tyre mesatare deri në plotësimin e kuotave të shpallura.
4. Parapëlqehen kandidatët që e kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve pranë UV-së.

• **Master i Shkencave në " Marrëdhënie Ndërkombëtare "**

1. Kanë të drejtë të aplikojnë kandidatët që kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë në një program të ciklit të parë Bachelor në «Drejtësi» ose fusha të përafërta.
2. Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë "Bachelor" ose në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë në «Drejtësi» ose fusha të përafërta dhe kanë kryer njësimin e diplomës pranë MAS.
3. (vetëm për aplikantët në programin e studimeve **Master shkencor**): përmbushin detyrimin e njohjes së gjuhës së huaj të parashikuar nga neni 76, pika 4 e ligjit nr.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".

4. Përcaktimi i kandidatëve fitues do të kryhet sipas rendit zbritës së notës së tyre mesatare, deri në plotësimin e kuotave të shpallura.
5. Do të kenë përparësi kandidatët që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në drejtësi pranë UIQV-së, si dhe kandidatët e diplomuar pranë Akademisë së Sigurisë dhe Hetimit pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Shqipërisë

• **Master i Shkencave në "Mësimdhënie e Gjuhës shqipe dhe Letërsisë"**

Kanë të drejtë të aplikojnë kandidatët që:

1. Kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë në një program të ciklit të parë "Bachelor" në Gjuhë shqipe dhe Letërsi.
2. Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë "Bachelor Gjuhë shqipe dhe Letërsi" dhe kanë kryer njësimin e diplomës pranë MAS-it.
3. Përcaktimi i kandidatëve fitues do të kryhet sipas rendit zbritës të notës së tyre mesatare deri në plotësimin e kuotave të shpallura.
4. Parapëlqehen kandidatët që e kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve pranë UV-së.
5. Kriteri i gjuhës së huaj: dëshmi për njohuri në nivelin B1 të njërës prej 5 gjuhëve të huaja të përcaktuara sipas udhëzimit Nr. 52, datë 3.12.2015 i ndryshuar me udhëzimin Nr. 10, datë 16.06.2023.

• **Master i Shkencave në "Edukim"**

1. Kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë në një program të ciklit të parë "Bachelor" në *"Pedagogji e specializuar"* *"Mësuesi për Arsmin Fillor"*, *"Mësuesi për Arsimin Parashkollor"*, dhe degë të tjera me drejtim mësuesi.
2. Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë "Bachelor" në mësuesi dhe kanë kryer njësimin e diplomës pranë MAS-it.
3. Përcaktimi i kandidatëve fitues do të kryhet sipas rendit zbritës të notës së tyre mesatare deri në plotësimin e kuotave të shpallura.
4. Parapëlqehen kandidatët që e kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve pranë UV-së.
5. Kriteri i gjuhës së huaj: dëshmi për njohuri në nivelin B1 të njërës prej 5 gjuhëve të huaja të përcaktuara sipas udhëzimit Nr. 52, datë 3.12.2015 i ndryshuar me udhëzimin Nr. 10, datë 16.06.2023.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

• **Master i Shkencave në "Pedagogji e Specializuar Sociale"**

Kanë të drejtë të aplikojnë kandidatët që:

1. Kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë në një program të ciklit të parë "Bachelor" në *"Pedagogji e specializuar"* *"Mësuesi për Arsmin Fillor"*, *"Mësuesi për Arsimin Parashkollor"*, dhe degë të tjera me drejtim mësuesi.
2. Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë "Bachelor" në mësuesi dhe kanë kryer njësimin e diplomës pranë MAS-it.
3. Përcaktimi i kandidatëve fitues do të kryhet sipas rendit zbritës të notës së tyre mesatare deri në plotësimin e kuotave të shpallura.
4. Parapëlqehen kandidatët që e kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve pranë UV-së.
5. Kriteri i gjuhës së huaj: dëshmi për njohuri në nivelin B1 të njërës prej 5 gjuhëve të huaja të përcaktuara sipas udhëzimit Nr. 52, datë 3.12.2015 i ndryshuar me udhëzimin Nr. 10, datë 16.06.2023.

• **Doktoraturë në "Studime gjuhësore, letrare e kulturore"**

1. Të zotërojnë diplomë të ciklit të dytë të studimeve "Master i Shkencave", diplomë të integruar të studimeve të ciklit të dytë ose çdo diplomë tjetër të vlerësuar të barazvlefshme me të, diplomë të fituar jashtë vendit të njohur dhe të njësuar nga organet kompetente, në fushat/nënfushat e mëposhtme të studimit:
 - studime letrare;
 - gjuhësi;
 - mësimdhënie e gjuhës së huaj (angleze, italiane, etj);
 - mësimdhënie e gjuhës shqipe dhe letërsisë;
 - përkthim dhe interpretim;
 - komunikim (ndërkulturor).
 - fusha/nënfusha të tjera filologjike/humane që lidhen me studimin e gjuhës, letërsisë e kulturës/ave;
2. Të ketë notë mesatare të paktën 8 (tetë) në çdo diplomë që zotëron, të lëshuar nga IAL shqiptare apo të huaja;
3. Në rast numër të barabartë kandidatësh, prioritet u jepet kandidatëve që kanë ndjekur programet e studimit "Master i shkencave" pranë Departamentit të Gjuhëve të Huaja dhe Departamentit të Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë, Fakulteti i Shkencave Humane, UV;
4. Nëse numri i kandidatëve është sërish i barabartë, prioritarë do të jenë kandidatët që janë anëtarë të personelit akademik të këtyre njësive;
5. Të zotërojnë një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht dhe italisht), niveli B 2, e vërtetuar përmes testeve të njohura



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

ndërkombëtare, në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin e lartë. Ky kriter është i vlefshëm për kandidatë që kanë fituar një diplomë të një programi studimi që nuk është kryer në një nga këto gjuhë;

6. Të dëshmojë pjesëmarrje në aktivitete mësimdhënëse universitare dhe shkencore (konferenca, seminare, kongrese, simpoziume) dhe publikime në fushat/nënfishat e programit të doktoratës;
7. Të ketë hartuar projektpropozimin sipas kërkesave në shtojcën 1 në Rregulloren për organizimin e ciklit të tretë të studimeve (doktoratë) në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë.

III. FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE

• **Program Profesional "Akuakulturë dhe Higjenë e Produkteve të Peshkimit"**

1. Përzgjedhja do të bëhet sipas renditjes së maturantëve kandidatë, në bazë të mesatares së Shkollës së Mesme e përlogaritur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.
2. Ndër kandidatët me pikë të barabarta në Akuakulturë dhe Higjenë e Produkteve të Peshkimit, përparësi kanë kandidatët që kanë mesatare më të lartë në lëndën Biologji në tre vitet e studimit në shkollën e mesme.

• **Program Profesional "Teknik laborator kimik"**

1. Përzgjedhja e studentëve të bëhet bazuar në renditjen e maturantëve kandidatë në bazë të mesatares së Shkollës së Mesme.
2. Rënditja e studentëve do të bëhet sipas rendit zbritës së mesatares së ponderuar së Shkollës së Mesme.
3. Ndër kandidatët me pikë të barabarta përparësi kanë kandidatët që kanë mesatare më të lartë në lëndën Kimi në tre vitet e studimit në Shkollën e Mesme

• **Master Shkencor në Inxhinieri Armatimi me profil Minor në Aviacion dhe Naval**

Për të qenë pjesë e këtij programi master, aplikantët duhet të plotësojnë këto kritere:

1. Të kenë përfunduar me sukses një program studimi të ciklit të parë (Bachelor) në fushat e Inxhinierisë Mekanike, Elektrike, Elektronike, Kimi Industriale, Akademisë së Forcave të Armatosura, Forcës Ajrore, Inxhinierisë Navale, ose fusha të tjera të afërta teknike të njohura nga institucioni.
2. Gjuha huaj sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë
Kritere të tjera:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

- a) Të kenë një mesatare të përgjithshme të studimeve paraardhëse të paktën mbi pragun e vendosur nga universiteti.
- b) Përvojë të dokumentuar profesionale në sektorin e mbrojtjes ose industrisë inxhinierike.
- c) Kriteria të tjera, të përcaktuara nga marrëveshja ndërinstitucionale me Akademinë e Forcave të Armatosura ose me vendim të dy Senateve Akademike.
- d) Eksperiencë pune në fushën përkatëse brenda ose jashtë vendit.
- e) Kandidati duhet të ketë njohuri bazë në mekanikë, rezistencë materiale, sistemet mekanike dhe teknologjitë e prodhimit janë të domosdoshme për ndjekjen me sukses të programit.

• **Bachelor në "Kimi"**

1. Renditja e studentëve do të bëhet sipas rendit zbritës të mesatares së ponderuar të shkollës së mesme.
2. Ndër kandidatët me pikë të barabarta përparësi kanë kandidatët që kanë mesatare më të lartë në lëndën Kimi në tre vitet e studimit në Shkollën e Mesme.

• **Bachelor në "Matematikë"**

1. Pranimi i studentëve në programin e studimit Bachelor në Matematikë do të bëhet sipas renditjes së maturantëve kandidatë, në bazë të mesatares së Shkollës së Mesme e përllogaritur nga Ministria e Arsimit.
2. Ndër kandidatët me pikë të barabarta përparësi kanë kandidatët që kanë mesatare më të lartë në lëndën Matematikë dhe Fizikë në tre vitet e studimit në Shkollën e Mesme.

• **Bachelor në "Informatikë"**

1. Renditja e maturantëve kandidatë në bazë të mesatares së përgjithshme të Shkollës së Mesme, nga më e larta tek më e ulëta, në rend zbritës, ndërsa kufiri do të jetë kuota e fundit.
2. Në rast të pikëve të barabarta, përparësi do të kenë ata kandidatë që kanë mesatare më të lartë në lëndën Informatikë gjatë tre viteve të studimit në Shkollën e Mesme.

• **Bachelor në "Teknologji Informatike"**

1. Renditja e maturantëve kandidatë në bazë të mesatares së përgjithshme të Shkollës së Mesme, nga më e larta tek më e ulëta, në rend zbritës, ndërsa kufiri do të jetë kuota e fundit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

2. Në rast të pikëve të barabarta, përparësi do të kenë ata kandidatë që kanë mesatare më të lartë në lëndën Informatikës gjatë tre viteve të studimit në Shkollën e Mesme.

- **Bachelor në "Shkenca Kompjuterike"**

1. Renditja e maturantëve kandidatë në bazë të mesatares së përgjithshme të Shkollës së Mesme, nga më e larta tek më e ulëta, në rend zbritës, ndërsa kufiri do të jetë kuota e fundit.
2. Në rast të pikëve të barabarta, përparësi do të kenë ata kandidatë që kanë mesatare më të lartë në lëndën Informatikës gjatë tre viteve të studimit në Shkollën e Mesme.

- **Bachelor në Computer Engineering**

1. Mbeshtetur në Rregulloren e Programit të Studimit, neni 26 - Politikat e pranimit: Çdo vit akademik, pranohen në programin "Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike" student nga Republika e Shqipërisë, shqiptarë etnikë nga rajone të tjera, si dhe studentë nga vende të tjera, me kusht që kandidatët të kenë njohuri të gjuhës angleze në nivelin B1 ose më të lartë
2. Kenë diplomë të shkollës së mesme (Maturë);
3. Kenë përfunduar provimet e Maturës Shtetërore (provime të detyrueshme dhe me zgjedhje);
4. Të paraqesin certifikatën e njohjes së gjuhës angleze (niveli B1 ose më i lartë); Sipas Nenit 28 - Dokumentacioni i pranimit:
 - a) Për kandidatët shqiptarë, aplikimi për programin "Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike" bazohet në Udhëzimin Nr. 12, datë 30.06.2023, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS), "Për procedurat e aplikimit dhe regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë."
 - b) Përzgjedhja bazohet në renditjen e studentëve sipas pikëve të grumbulluara, nga më e larta në më të ulëtën, të llogaritura në bazë të notës mesatare të shkollës së mesme dhe rezultateve të provimeve të Maturës Shtetërore.
 - c) Në rast se kandidatët kanë të njëjtin total pikësh, kriter përzgjedhës do të jenë rezultatet në provimet me zgjedhje (Matematikë, Fizikë).

- **Program Profesional në Programim Web dhe Dizenjim Digjital**

1. Pranimi i studentëve në programin e studimit profesional 2- vjecar "Programim Web dhe Dizenjim Digjital" do të kryhet bazuar në renditjen e maturantëve kandidatë sipas mesatares së përgjithshme të Shkollës së Mesme, nga më e larta tek më e ulëta, në rend zbritës, ndërsa kufiri do të jetë kuota e fundit.
2. Në rast të pikëve të barabarta, si kriter përzgjedhjeje do të shërbejnë pikët e provimeve me zgjedhje.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

• **Bachelor në "Matematikë-Fizikë"**

1. Përzgjedhja do të bëhet sipas renditjes së maturantëve kandidatë në bazë të mesatares së Shkollës së Mesme e përlogaritur nga Ministria e Arsimit.
2. Ndër kandidatët me pikë të barabarta në Bachelor Matematikë-Fizikë përparësi kanë kandidatët që kanë mesatare më të lartë në lëndët Matematikë dhe Fizikë në tre vitet e studimit në Shkollën e Mesme.

• **Bachelor në "Inxhinieri Navale"**

1. Kriteri përzgjedhës me 100% të pikëve do të jetë renditja sipas mesatares së shkollës së mesme, me nivel mesatar të përcaktuar nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë.
2. Nëse do të ketë studentë me të njëjtën mesatare dhe me pikë të njëjta në rankim, si kriter përzgjedhës i rankimit do të merret mesatarja e Matematikës, nëse përsëri do të ketë studentë me pikë të njëjta do të merret mesatarja e Fizikës, dhe nëse edhe pas këtij rankimi do të rezultojnë studentë me mesatare të njëjtë si kriter përzgjedhës do të merret mesatarja e Kimisë.

• **Bachelor në "Inxhinieri Mekanike"**

1. Kriteri përzgjedhës me 100% të pikëve do të jetë renditja sipas mesatares së shkollës së mesme, me nivel mesatar të përcaktuar nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë.
2. Nëse do të ketë studentë me të njëjtën mesatare dhe me pikë të njëjta në rankim, si kriter përzgjedhës i rankimit do të merret mesatarja e Matematikës, nëse përsëri do të ketë studentë me pikë të njëjta do të merret mesatarja e Fizikës, dhe nëse edhe pas këtij rankimi do të rezultojnë studentë me mesatare të njëjtë si kriter përzgjedhës do të merret mesatarja e Kimisë.
3. Bachelor në "Inxhinieri Mekanike" me Universitetin Politeknik të Barit respektohen kriteret e përcaktuara në marrëveshjen e bashkëpunimit me Universitetin Politeknik të Barit.

• **Bachelor në "Inxhinieri Elektrike"**

1. Kriteri përzgjedhës me 100% të pikëve do të jetë renditja sipas mesatares së shkollës së mesme, me nivel mesatar të përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.
2. Nëse do të ketë studentë me të njëjtën mesatare dhe me pikë të njëjta në rankim, si kriter përzgjedhës i rankimit do të merret mesatarja e Matematikës, nëse përsëri do të ketë studentë me pikë të njëjta do të merret mesatarja e Fizikës, dhe nëse edhe pas këtij rankimi do të rezultojnë studentë me mesatare të njëjtë si kriter përzgjedhës do të merret mesatarja e Kimisë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

• **Bachelor në "Biologji"**

1. Përzgjedhja e studentëve të bëhet bazuar në kriterin e notës mesatare duke i vendosur në rendin zbritës deri në plotësimin e kuotave të miratuara për diplomën përkatëse.
2. Ndër kandidatët me pikë të barabarta në Bachelor në Biologji, përparësi kanë kandidatët që kanë mesatare më të lartë në lëndën Biologji në tre vitet e studimit në shkollën e mesme.

1. **Bachelor në "Navigacion"**

1. Do të bëhet renditja e maturantëve kandidatë në bazë të mesatares së Shkollës së Mesme.
2. Ndër kandidatët me pikë të barabarta përparësi kanë kandidatët që kanë mesatare më të lartë në lëndën Informatikë në tre vitet e studimit në Shkollën e Mesme.
3. **Bachelor në Navigacion** do të bëhet sipas renditjes së maturantëve kandidatë, në bazë të mesatares së Shkollës së Mesme e përlogaritur nga Ministria e Arsimit. Mesater minimale e notes mesatare eshte nota 6.0

Ndër kandidatët me pikë të barabarta në, përparësi kanë kandidatët që kanë mesatare më të lartë në lëndën **Informatike dhe Gjuhe te Huaj**, në tre vitet e studimit në shkollën e mesme.

• **Diplomë Profesionale të ofruara nga DSHD: "Specialist në Shërbime dhe Operacione Detare e Bregdetare"**

1. Do të bëhet sipas renditjes së maturantëve kandidatë, në bazë të mesatares së Shkollës së Mesme e përlogaritur nga Ministria e Arsimit.
2. Ndër kandidatët me pikë të barabarta në, përparësi kanë kandidatët që kanë mesatare më të lartë në lëndën **Informatike dhe Gjuhe te Huaj**, në tre vitet e studimit në shkollën e mesme.

• **Master Profesional në "Mësuesi në Arsimin e Mesëm në lëndën Matematikë"**

1. Të drejtë regjistrimi në ciklit të dytë, sipas modelit 3+2 kanë kandidatët që kanë diplomë universiteti të ciklit të parë, nga studimet trevjeçare (180 ECTS kredi) apo katërvjeçare (240 ECTS), si më poshtë:
 - Bachelor në Matematikë, Bachelor në Fizikë, Bachelor në Matematikë-Fizikë, Bachelor në programe studimi të cilat kanë mbi 70% mbivendosje me programin studimor për të cilin konkurohet.
 - Rënditja e kandidat studentëve do të bëhet duke filluar nga mesatarja më e lartë e diplomës e arritur në studimet e ciklit të parë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

• **Master Profesional në "Mësuesi në Arsimin e Mesëm në Biologji, me profil minor në Kimi"**

1. Përzgjedhja e studentëve të bëhet bazuar në kriterin e notës mesatare duke i vendosur në rendin zbritës deri në plotësimin e kuotave të miratuara për diplomën përkatëse.
2. Kriteret preferenciale
 - Jepet përparësi kandidatëve që kanë përfunduar Ciklin e Parë të studimeve në IAL-publike, dhe pastaj atyre që vijnë nga IAL-jopublike
 - Jepet përparësi kandidatëve që kanë përfunduar Ciklin e Parë të studimeve në programet e studimit në Biologji në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë.
 - Jepet përparësi studentëve që kanë ngjashmëri të diplomës së Ciklit të Parë të studimeve me diplomën e Ciklit të Dytë për të cilën aplikojnë.

• **Master Profesional në "Mësuesi për Ciklin e Lartë të Arsimit Baze në lëndët Matematikë-Fizikë"**

1. Të drejtë regjistrimi në ciklin e dytë, sipas modelit 3+2 kanë kandidatët që kanë diplomë universiteti të ciklit të parë, nga studimet trevjeçare (180 ECTS kredi) apo katërvjeçare (240 ECTS), si më poshtë:
 - Bachelor në Fizikë, Bachelor në Matematikë-Fizikë, Bachelor në programe studimi të cilat kanë mbi 70% mbivendosje me programin studimor për të cilin konkurohet.
 - Renditja e kandidat studentëve do të bëhet duke filluar nga mesatarja më e lartë e diplomës e arritur në studimet e ciklit të parë.

• **Master Profesional në "Mësuesi për Arsimin e Mesëm në Lëndën Informatikë"**

Titujtë e programeve të studimit të ciklit të parë që mundësojnë pranimin në Master Profesional, që duhen patur parasysh për pranimin sipas preferencës listohen si më poshtë.

- Bachelor në Shkenca Kompjuterike, Teknologji Informacioni, Informatikë, Shkenca Kompjuterike, Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë.
- Bachelor të fakulteteve të tjera ne degët e Shkencave Kompjuterike të shkollave publike, vendase e të huaja pasi të jetë bërë njohja e tyre sipas rregullores përkatëse të fakultetit.
- Bachelor të fakulteteve të tjera ne degët e Shkencave Kompjuterike të shkollave jo publike, vendase e të huaja pasi të jetë bërë njohja e tyre sipas rregullores përkatëse të fakultetit.
- Do të pranohet të njihen të gjitha diplomat Bachelor Dega Informatikë Ekonomike .
- Bachelor në Matematikë, Matematikë-Fizikë, Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

- Bachelor të fakulteteve të tjera në degët Matematikë, Matematikë-Fizikë të shkollave publike, vendase e të huaja pasi të jetë bërë njohja e tyre sipas rregullores përkatëse të fakultetit.
- Bachelor të fakulteteve të tjera në degët Matematikë, Matematikë-Fizikë të shkollave jo publike, vendase e të huaja pasi të jetë bërë njohja e tyre sipas rregullores përkatëse të fakultetit.
- Studentët fitues në këto programe do të për zgjidhen mbi bazën e mesatares së arritur në studimet e ciklit të parë (bachelor) sipas parimit të meritës dhe kërkesës së aplikantit.
- **Master Profesional në "Studime të Avancuara Detare"**
 1. Përzgjedhja e studentëve do të bëhet bazuar në kriterin e notës mesatare duke i vendosur në rendin zbritës deri në plotësimin e kuotave të miratuara për diplomën përkatëse.
 2. Krite preferenciale gjatë listimit të kandidatëve:
 - a) Jepet përparësi kandidatëve që kanë përfunduar Ciklin e Parë të Studimeve në programet e studimit në FSHTN, në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë.
 - b) Jepet përparësi studentëve që kanë ngjashmëri të diplomës së Ciklit të Parë të Studimeve me diplomën e Ciklit të Dytë për të cilën aplikojnë.
- **Master Profesional në "Mësimdhenie në Kimi për Arsimin e Mesëm të Ulët"**
 1. Pranohen kandidatët që zotërojnë një diplomë Bachelor në Kimi ose Bio-kimi.
 2. Përparësi kanë kandidatët që zotërojnë një diplomë Bachelor në fushën e studimit Kimi dhe më pas ata në Bio-Kimi.
 3. Kriter është nota mesatare e diplomes që zotëron kandidati.

Kritere shtesë:

 - Renditja sipas rendit zbritës të mestares së ponderuar të diplomës Bachelor.
 - Preferohen studentet nga IAL publike dhe më pas nga ato Jopublike.
 - Preferohen aplikantë në ciklet e studimit sipas renditjes së mëposhtme:
 - Bachelor Kimi
 - Bachelor Bio-Kimi
 - Bachelor Kimi Industriale e Mjedisore
 - Bachelor Kimi e Teknologji ushqimore
- **Master Profesional në "Operacione Industriale dhe Navale"**
 1. Kandidatët të jenë të diplomuar në disipinat e Inxhinierisë Navale, Mekanike, ose në fusha të përafërta me to.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

2. Përzgjedhja e studentëve do të bëhet bazuar në kriterin e notës mesatare duke i vendosur në rendin zbritës deri në plotësimin e kuotave të miratuara për diplomën përkatëse.
3. Të gjithë kandidatët duhet të plotësojnë detyrimet sipas Udhëzimit përkatës të Ministrisë së Arsimit Rinisë dhe Sportit.
4. Krite preferenciale gjatë listimit të kandidatëve:
 - Jepet përparësi kandidatëve që kanë përfunduar Ciklin e Parë të studimeve në IAL^{-të} publike, dhe pastaj atyre që vijnë nga IAL^{-të} jopublike
 - Jepet përparësi kandidatëve që kanë përfunduar Ciklin e Parë të studimeve në programet e studimit në FSHT, në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë.
 - Jepet përparësi studentëve që kanë ngjashmëri të diplomës së Ciklit të parë të studimeve me diplomën e Ciklit të Dytë për të cilën aplikojnë.

• **Master i Shkencave në "Mësuesi AML në Kimi"**

Pranohen kandidatët që zoterojnë një diplomë Bachelor në Kimi ose Bio-kimi.

1. Përparësi kanë kandidatët që zotërojnë një diplomë Bachelor në fushën e studimit Kimi dhe me pas do të renditen kandidatët të cilët zotërojnë një diplomë në fushën Bio-Kimi.
2. Kandidatët do të përzgjidhen mbi bazën e notës mesatare dhe diplomës që zotëron kandidati.
4. Krite shtesë:
 - Të renditen studentët sipas rendit zbritës të mesatares së ponderuar të Diplomës Bachelor
 - Të preferohen studentët e IAL Publike dhe më pas IAL Jopublike
 - Të preferohen aplikantët në cikle studimi me prioritet listuar si më poshtë:
 - Bachelor në Kimi
 - Bachelor në Bio-Kimi
 - Bachelor në Kimi Industriale e Mjedisore
 - Bachelor në Kimi dhe Teknologji Ushqimore

• **Master i Shkencave në "Biologji Mjedisore",**

1. Përzgjedhja e studentëve të bëhet bazuar në kriterin e notës mesatare duke i vendosur në rendin zbritës deri në plotësimin e kuotave të miratuara për diplomën përkatëse.
2. Krite preferenciale
 - Jepet përparësi kandidatëve që kanë përfunduar Ciklin e Parë të studimeve në IAL-publike, dhe pastaj atyre që vijnë nga IAL-jopublike.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

- Jepet përparësi kandidatëve që kanë përfunduar Ciklin e Parë të studimeve në programet e studimit në Biologji, në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë.
- Jepet përparësi studentëve që kanë ngjashmëri të diplomës së Ciklit të parë të studimeve me diplomën e Ciklit të Dytë për të cilën aplikojnë.

- **Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike"**

Titujtë e programeve të studimit të ciklit të parë që mundësojnë pranimin në Programet e ciklit të dytë, që duhen patur parasysh për pranimin sipas preferencës listohen si më poshtë.

- Bachelor në Shkenca Kompjuterike, Teknologji Informacioni, Informatikë, Shkenca Kompjuterike, Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë.
- Bachelor të fakulteteve të tjera në degët e Shkencave Kompjuterike, Inxhinierisë Elektronike, si dhe Inxhinieri të tjera të shkollave publike, vendase e të huaja pasi të jetë bërë njohja e tyre sipas rregullores përkatëse të fakultetit.
- Bachelor të fakulteteve të tjera në degët e Shkencave Kompjuterike të shkollave jo publike, vendase e të huaja pasi të jetë bërë njohja e tyre sipas rregullores përkatëse të fakultetit.
- Do të pranohet të njihen të gjitha diplomat Bachelor Dega Informatikë Ekonomike, dhe Bachelor në Ekonomi.
- Bachelor në Inxhinieri Elektrike, Matematikë, Matematikë-Fizikë, Fakulteti i Shkencave Teknike Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë.
- Bachelor të fakulteteve të tjera në degët e Inxhinieri Elektrike, Matematikë, Matematikë-Fizikë, dhe Inxhinieri të tjera të shkollave publike, vendase e të huaja pasi të jetë bërë njohja e tyre sipas rregullores përkatëse të fakultetit.
- Bachelor të fakulteteve të tjera në degët e Inxhinieri Elektrike, Matematikë, Matematikë-Fizikë, dhe Inxhinieri të tjera të shkollave jo publike, vendase e të huaja pasi të jetë bërë njohja e tyre sipas rregullores përkatëse të fakultetit.

Studentët fitues në këto programe do të përzgjidhen mbi bazën e mesatares së arritur në studimet e ciklit të parë (bachelor) sipas parimit të meritës dhe kërkesës së aplikantit.

- **Master i Shkencave në "Maritime Environmental Protection and Management"**
"Mbrotjtja dhe Menaxhimi i Mjedisit Detar"

1. Përzgjedhja e studentëve të bëhet bazuar në kriterin e notës mesatare minimale 7 (shtatë) duke i vendosur në rendin zbritës deri në plotësimin e kuotave të miratuara për diplomën përkatëse.

1. Kandidatët në momentin e aplikimit duhet të paraqesin nivelin e njohurive gjuhësore angleze minimalisht niveli B1 sipas akteve ligjore, Udhëzimit 52, datë 03.12.2015 si dhe shkresës nr.3228 prot, datë 27.05.2018.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

2. Studentët të cilët zotërojnë një diplomë të ciklit të dytë MP ose MSc, pranohen pa plotësuar kushtin e përmbushjes së mesatares 7(shtatë) në studimet Bachelor.
3. Kriteria preferenciale gjatë listimit të kandidatëve:
 - Jepet përparësi kandidatëve që kanë përfunduar Ciklin e Parë të Studimeve në programet e studimit FSHTN në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë.
 - Jepet përparësi studentëve që kanë ngjashmëri të diplomës së Ciklit të Parë të Studimeve me diplomën e Ciklit të dytë për të cilën aplikojnë.
 - Departamenti i Shkencave Detare për vitin akademik 2026-27 propozon që pranimi i studentëve në Master Profesional të ofruara nga DSHD: **"Studime të Avancuara Detare"** do të bëhet sipas renditjes së ciklin Bachelor.
1. Departamenti i Shkencave Detare, propozon t'i kërkojë Senatit të UV për pranimin e studentëve në programin e studimit Master i Shkencave në "Maritime Environmental Protection and Management - Mbrojtja dhe Menaxhimi i Mjedisit Detar" miratimin e kriterit të notës 6.5 (gjashtë pikë pesë) të studimeve Bachelor për pranimin e studentëve mbështetur në VKM Nr. 436, datë 03.06.2020.

Për studentët që janë diplomuar me një diplomë të ciklit të dytë, Master Profesional dhe Master Shkencor pranimi i studentëve bëhet pa kriterin e notës mesatare.

- **"Master i Shkencave në Shkenca Kompjuterike,**

Sipas preferencës listohen si më poshtë:

1. Bachelor në Shkenca Kompjuterike, Teknologji Informacioni, Informatikë, Shkenca Kompjucionale, Fakulteti i Shkencave Teknike Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë.
2. Bachelor të fakulteteve të tjera në degët e Shkencave Kompjuterike, Inxhinierisë Elektronike, si dhe Inxhinieri të tjera të të njëjtës fushë të shkollave publike, vendase e të huaja pasi të jetë bërë njohja e tyre sipas rregullores përkatëse të fakultetit.
3. Bachelor të fakulteteve të tjera në degët e Shkencave Kompjuterike të shkollave jo publike, vendase e të huaja pasi të jetë bërë njohja e tyre sipas rregullores përkatëse të fakultetit.
4. Do të pranohet të njihen të gjitha diplomat Bachelor Dega Informatikë Ekonomike.
 - Bachelor në Inxhinieri Elektrike, Matematikë, Matematikë-Fizikë, Fakulteti i Shkencave Teknike Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

- Bachelor të fakulteteve të tjera në degët Matematikë, Matematikë-Fizikë, Inxhinieri Elektrike, dhe Inxhinieri të tjera të shkollave publike, vendase e të huaja pasi të jetë bërë njohja e tyre sipas rregullores përkatëse të fakultetit.

- Bachelor të fakulteteve të tjera në degët Matematikë, Matematikë-Fizikë, Inxhinieri Elektrike, dhe Inxhinieri të tjera të shkollave jo publike, vendase e të huaja pasi të jetë bërë njohja e tyre sipas rregullores përkatëse të fakultetit.

- Bazuar në Rregulloren e UV, Neni 70 "Pranimi në Programet e Ciklit të Dytë të Studimeve"

pika 3 përcaktohet "Kriter pranimi në një program studimi të ciklit të dytë "Master i shkencave" është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian : anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht. Nëse individ ka fituar një

Diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi përplotësimin e këtij kriteri. Niveli i gjuhës përcaktohet me akt nënligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.

- Studentët fitues në këto programe do të përzgjidhen mbi bazën e mesatares së arriturur në studimet e ciklit të parë (bachelor) sipas parimit të meritës dhe kërkesës së aplikantit.

Bachelor në Shkenca Arkitekturore në Trashëgimi

1. Diplomë e shkollës së mesme/Diplomë ekuivalente.
2. Kriteri i notës mesatare për hyrjen në program do të jetë sipas legjislacionit në Shqipëri dhe atij në Itali.
3. Gjuhë e huaj: Njohja e gjuhës angleze: Kërkohet niveli minimal B1, i cili vërtetohet në momentin e regjistrimit përmes një certifikatë të përshtatshme. Për studentet që nuk kanë një certifikatë të gjuhës së huaj, vlerësimi për nivelin e gjuhës do të bëhet në Qendrën e Gjuhëve në Universitetin Politeknik të Barit, në 11 Shtator 2026. Për këtë test studentët duhet të regjistrohen nëpërmjet adresës e-mail languages@poliba.it
4. Kriterë shtesë për diplomim: Njohja e gjuhës italiane për studentët e huaj: Kërkohet niveli B2, i cili duhet të arrihet dhe të vërtetohet përmes një certifikate përpara mbrojtjes së diplomës përfundimtare. Gjatë dy semestreve në Itali, studentët e huaj mund ta përfitojnë këtë njohuri duke ndjekur kurse falas të gjuhës italiane në Qendrën e Gjuhëve të Politeknikut të Barit.
5. Konkursi i pranimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

IV. FAKULTETI I SHENDETIT

• **Bachelor në "Infermieri të Përgjithshme"**

1. Kriteri përzgjedhës me 100% të pikëve do të jetë mesatarja e përgjithshme e shkollës së mesme, me nivel minimal të përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, e llogaritur nga QSHA sipas rendit zbritës.
2. Kandidatët do të renditen në rend zbritës sipas mesatares së shkollës së mesme të përllogaritur nga QSHA.
3. Në rast se do të ketë kandidatë me pikë të barabarta, renditja do të bëhet në rend zbritës sipas mesatares së 3 (tre) viteve të lëndës së Biologjisë.
4. Në rast se sërish do të ketë kandidatë me pikë të barabarta, renditja do të bëhet në rend zbritës sipas mesatares së 3 (tre) viteve të lëndës së Kimisë.

• **Bachelor në "Infermieri Mami"**

1. Kriteri përzgjedhës me 100% të pikëve do të jetë mesatarja e përgjithshme e shkollës së mesme, me nivel minimal të përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, e llogaritur nga QSHA sipas rendit zbritës.
2. Kandidatët do të renditen në rend zbritës sipas mesatares së shkollës së mesme të përllogaritur nga QSHA.
3. Nëse do të ketë kandidatë me pikë të barabarta, renditja do të bëhet në rend zbritës sipas mesatares së 3 (tre) viteve të lëndës së Biologjisë.
4. Nëse sërish do të ketë kandidatë me pikë të barabarta, renditja do të bëhet në rend zbritës sipas mesatares së 3 (tre) viteve të lëndës së Kimisë.

Master Profesional në "Infermieri Patologjike"

- Pranohen kandidatët që zotërojnë diploma e mëposhtme :
 - Diplomë Bachelor në Infermieri të përgjithshme
 - Diplomë Bachelor në Infermieri Mami
 - Diplomë Bachelor në Infermieri në Shëndet Publik
 - Diplomë Bachelor në Teknik Laboratori
 - Diplomë Bachelor në Fizioterapi
 - Diplomë Bachelor në Teknik Radiolog
 - Diplomë Bachelor në Higjienist Dentar
 - Diplomë të sistemit të vjetër: Infermier i përgjithshëm
- Këto diploma duhet të jenë të fituara në përfundim të ciklit të parë të studimeve në të gjitha Fakultetet apo Shkollat e Larta të Infermierisë Brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

- Përzgjedhja e kandidatëve në Masterin Profesional në Infermieri Patologjike do të bëhet në bazë të rendit zbritës të mesatares së ponderuar të notave të tyre në ciklin e parë të studimeve. Nëse do të ketë studentë me të njëjtën mesatare në Programin Bachelor në fund të listës, renditjen do ta përcaktojë lëndët specifike.
- Lëndët specifike në programin Master Profesional në Infermieri Patologjike do të jenë modulet e lëndëve Sëmundje e Brendëshme. Nëse do të ketë përsëri studentë me të njëjtën mesatare Bachelor në fund të listës, pas mesatares me lëndët specifike, renditjen do ta përcaktojë moduli i lëndës Infermieri Speciale për Adultin.
- Politika përzgjedhëse e kandidatëve do të jetë si më poshtë:
 - Studentët që kanë kryer studimet në UV.
 - Studentët që kanë kryer studimet në Institucione Publike të Arsimit të Lartë.
 - Studentët që kanë kryer studime në Institucione Private të Arsimit të Lartë
- **Për Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale"**
 1. Pranohen kandidatët që zotërojnë diploma e mëposhtme të fituara në përfundim të ciklit të parë të studimeve në të gjitha Fakultetet apo Shkollat e Larta të Infermierisë Brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë:
 - Diplomë Bachelor në Infermieri të përgjithshme
 - Diplomë Bachelor në Infermieri mami
 - Diplomë Bachelor në Infermieri në Shëndet Publik
 - Diplomë Bachelor në Teknik Laboratori
 - Diplomë Bachelor në Fizioterapi
 - Diplomë Bachelor në Teknik Radiolog
 - Diplomë Bachelor në Higjienist Dentar
 - Diplomë të sistemit të vjetër: Infermier i përgjithshëm
 2. Këto diploma duhet të jenë të fituara në përfundim të ciklit të parë të studimeve në të gjitha Fakultetet apo Shkollat e Larta të Infermierisë Brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
 3. Përzgjedhja e kandidatëve në Masterin Profesional në Infermieri Kirurgjikale do të bëhet në bazë të rendit zbritës të mesatares së ponderuar të notave të tyre në ciklin e parë të studimeve. Nëse do të ketë studentë me të njëjtën mesatare Bsc në fund të listës, renditjen do ta përcaktojë lëndët specifike: qe do të jetë moduli i lëndës Bazat e Kirurgjisë . Nëse do të ketë përsëri studentë me të njëjtën mesatare Bsc në fund të listës, pas mesatares me lëndët specifike, renditjen për të dy masterat do ta përcaktojë moduli i lëndës Infermieri Speciale për Adultin .
 4. Politika përzgjedhëse e kandidatëve do të jetë si më poshtë:
 - Studentët që kanë kryer studimet në UV.
 - Studentët që kanë kryer studimet në Institucione Publike të Arsimit të Lartë.
 - Studentët që kanë kryer studime në Institucione Private të Arsimit të Lartë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

• **Master Profesional në "Infermieri Pediatrike"**

1. Pranohen kandidatët që zotërojnë diploma e mëposhtme :
 - Diplomë Bachelor në Mami Infermieri
 - Diplomë Bachelor në Infermieri të përgjithshme
 - Diplomë Bachelor në Logopedi
 - Diplomë Bachelor në Fizioterapi
 - Diplomë Bachelor në Teknik Imazherie dhe Radioterapi
 - Diplomë Bachelor në Higjenë/Laborant Dentar
 - Diplomë të sistemit të vjetër: Infermieri përgjithshme
2. Këto diploma duhet të jenë të fituara në përfundim të ciklit të parë të studimeve në të gjitha Fakultetet apo Shkollat e Larta të Infermierisë Brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
3. Përzgjedhja e kandidatëve në Masterin Profesional në Infermieri Pediatrike do të bëhet në bazë të rendit zbritës të mesatares së ponderuar të notave të tyre në ciklin e parë të studimeve. Nëse do të ketë studentë me të njëjtën mesatare Bachelor në fund të listës, renditjen do ta përcaktojnë lëndët specifike.
4. Lëndët specifike në programin Master Profesional në Infermieri Pediatrike do të jenë modulet e lëndëve Pediatri. Nëse do të ketë përsëri studentë me të njëjtën mesatare në Programin Bachelor në fund të listës, pas mesatares me lëndën specifike, renditjen do ta përcaktojë moduli i lëndës "Kujesi për nënën dhe fëmijën"
5. Politika përzgjedhëse e kandidatëve të jetë si më poshtë:
 - Studentët që kanë kryer studimet në UV.
 - Studentët që kanë kryer studimet në Institucione Publike të Arsimit të Lartë.
 - Studentët që kanë kryer studime në Institucione Private të Arsimit të Lartë

• **Master i Shkencave në "Shkenca Infermierore"**

1. Pranohen kandidatët që zotërojnë diploma e mëposhtme :
 - Diplomë Bachelor në Infermieri të përgjithshme
 - Diplomë Bachelor në Infermieri Mami
 - Diplomë Bachelor në Infermieri në Shëndet Publik
 - Diplomë Bachelor në Teknik Laboratori
 - Diplomë Bachelor në Fizioterapi
 - Diplomë Bachelor në Teknik Radiolog
 - Diplomë Bachelor në Higjenist Dentar
 - Diplomë të sistemit të vjetër: Infermier i Përgjithshëm



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

2. Këto diploma duhet të jenë të fituara në përfundim të ciklit të parë të studimeve në të gjitha Fakultetet apo Shkollat e Larta të Infermierisë Brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
3. Përzgjedhja e kandidatëve në Masterin Shkencor në Shkenca Infermirore do të bëhet në bazë të rendit zbritës të mesatares së ponderuar të notave të tyre në ciklin e parë të studimeve. Mesatarja e diplomës së marrë në ciklin e parë të studimeve duhet të jetë ≥ 7.5
4. Politika përzgjedhëse e kandidatëve të jetë si më poshtë:
 - Studentët që kanë kryer studimet në UV.
 - Studentët që kanë kryer studimet në Institucione Publike të Arsimit të Lartë.
 - Studentët që kanë kryer studime në Institucione Private të Arsimit të Lartë.

• **Program Profesional Asistencë në Geriatri**

1. Në këtë program studimi kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë personat që:
 - kanë mbaruar arsimin e mesëm (12 vjet shkollë);
 - janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
 - kanë aftësi të ndryshme, por për të cilët shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin

Kriteri përzgjedhës me 100% të pikëve do të jetë mesatarja e përgjithshme e shkollës së mesme, pa nivel minimal sipas përcaktimeve nga Ministria e Arsimit dhe Sportit e llogaritur nga QSHA sipas rendit zbritës.

2. Kandidatët do të renditen në rend zbritës sipas mesatares së shkollës së mesme të përlogaritur nga QSHA.
3. Në rast se do të ketë kandidatë me pikë të barabarta, renditja do të bëhet në rend zbritës sipas mesatares së 3 (tre) viteve të lëndës së Biologjisë.
4. Në rast se sërisht do të ketë kandidatë me pikë të barabarta, renditja do të bëhet në rend zbritës sipas mesatares së 3 (tre) viteve të lëndës së Kimisë.